



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:167136
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05499580

KPPP.nr.1204/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit Shoqëria Tregtare “B.B.F.-Companu” Sh.P.K., me adresë në fshatin Gurëz-Ferizaj, me NUI: 810662082, kundër debitorit “Andi Group 2004” Sh.P.K., me adresë në Gjilan, rruga “Abdullah Tahiri” nr.170, me NUI: 811291046, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.S. avokat nga Gjilani, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.309/2022 të datës 22.09.2022, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Mubarak Shumolli me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 21.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Andi Group 2004” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.309/2022 të datës 22.09.2022, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Mubarak Shumolli, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, me Urdhrin Përbarimor P.nr.309/2022 të datës 22.09.2022, e ka caktuar përbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturave dhe atë: Faturës nr. 1918/21 të datës 04.08.2021, Faturës nr.1919/21 të datës 04.08.2021, Faturës nr.1932/21 të datës 04.08.2021, Faturës nr.2024/21 të datës 11.08.2021, Faturës nr.2026/21 të datës 11.08.2021,

Faturës nr.2027/21 të datës 11.08.2021, Faturës 3269/21 të datës 20.12.2021, Faturës nr.117/22 të datës 26.01.2022, Faturës nr.118/22 të datës 26.01.2022, dhe Faturës nr.119/22 të datës 26.01.2022, duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t'ia paguaj kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 1,508.53 Euro, me kamatëvonesë 8 % vjetore, dhe shpenzimet e përbarimit, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar lejimin e propozimit për përbarim, për shkak se ky propozim është bërë vetëm në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave, por këto fatura nuk përputhen me kartelën financiare, e gjithashtu të njëjtat mungojnë si prova ngase nuk i janë bashkangjitur propozimit fare, pra është në kundërshtim me nenin 30 të LPP-së, duke e bërë propozimin të papërshtatshëm për përbarim. Më tej ka theksuar se duke u bazuar në kartelën financiare të debitorit, shihet se debitori ka bërë pagesa të vazhdueshme ndaj kreditorit dhe se borxhi real i debitorit ndaj kreditorit nuk është si e ka kërkuar në propozimin për përbarim ngase edhe tani derisa është bërë propozimi për përbarim, debitori ka pagesë të kryer të një pjese të mallit tek tani kreditori. Ka shtuar se faturat e paraqitura në propozim nuk janë reale në shumën e tyre, ngase nuk është bërë fare zbritja konform kontratës, përkatësisht ankes kontratës në mes të kreditorit dhe debitorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit ndërsa të ndalohet në tërësi urdhri për përbarim i Përbaruesit Privat dhe të anulohen veprimet e kryera. I ka kërkuar edhe shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumën prej 312.00 Euro.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumën dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, ka evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm/faturat dhe atë : Faturën nr. 1918/21 të datës 04.08.2021, Faturën nr.1919/21 të datës 04.08.2021, Faturën nr.1932/21 të datës 04.08.2021, Faturën nr.2024/21 të datës 11.08.2021, Faturën nr.2026/21 të datës 11.08.2021, Faturën nr.2027/21 të datës 11.08.2021, Faturën 3269/21 të datës 20.12.2021, Faturën nr.117/22 të datës 26.01.2022, Faturën nr.118/22 të datës 26.01.2022, dhe Faturën nr.119/22 të datës 26.01.2022, me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky që vërtetohet me nënshkrimin dhe vulën e debitorit, pra rrjedhimisht debitori ka qenë i njoftuar me detyrimin që buron nga të njëjtat.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1204/23, me datë 21.03.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomen e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.